



QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVES

NR. 01/2012

Datë: 11.04.2012

Qendra Kinematografike e Kosovës në bazë të autoritetit të dhënë me Ligjin për Kinematografi Nr. 2004/22 të date: 08.07.2004, nxjerr këtë:

RREGULLORE PËR MIRATIMIN DHE SUBVENCIONIMIN E PROJEKTEVE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore përcakton mënyrën e miratimit dhe subvencionimit të projekteve filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK).

Neni 2

QKK, në përputhje me programin dhe potencialin financiar për vitin përkatës, jo më larg së dy muaj pas miratimit të mjeteve buxhetore, shpall konkurs për projekte filmike: për filma artistikë të metrazhit të gjatë e të shkurtër; për filma dokumentarë dhe për filma vizatimorë – të animuar.

SUBVENCIONIMI / BASHKEFINANCIMI

Neni 3

QKK nuk financon në lartësi më shumë se 51% të shumës së përgjithshme të projektit, përveç për filmin vizatimorë-të animuar dhe projektet filmike të kineastëve të posadiplomuar/debutant.

Subvencionimi për filmin vizatimor – të animuar dhe për projektet e kineastëve të posadiplomuar/debutant mund të jetë deri në 90%.

QKK nuk financon projektet të cilat nxisin ose mbështesin pornografinë, prostitucionin, përdorimin e narkotikëve, urrejtjen etnike, raciale apo religjioze, terrorizmin apo aktivitetet e tjera kriminale.

Bazuar ne Ligjin per Kin. Kreu 4, 25.2. QKK mund të subvencionojë zhvillimin e skenarit, postproduksionin, aktivitetet e promovimit, si te filmave te subvencionuar me pare, ashtu edhe te aktiviteteteve tjera promovuese kinematografike shtese.

QKK mund të vendos të hyn në koproduksion minor deri në 10% (shuma maksimale deri në 50 mijë euro për projekt) të vlerës së projektit (Minority coproduction) në projekte me shtetet tjera. Për lartësinë e përqindjes, vendos Këshillit Drejtues në konsultim paraprak me Komisionin financiar dhe sipas vlerësimit të Jurisë së Vlerësuese.

Në rast të koproduksioneve minore, jo më shumë se 40% nga shuma që ndan QKK për projektin filmik, mund të shpenzohet jashtë vendit, apo për person jo-shtetas i republikës së Kosovës.

KONKURSI

Neni 4

Të drejtë pjesëmarrje në konkurs kanë të gjithë personat juridikë, vendas ose të huaj të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit, të regjistruar/anëtarësuar në QKK si *producent*.

Neni 5

Pjesëmarrësit në konkurs duhet të paraqesin:

1. Skenarin,
2. Sinopsisin e shkurtër, (për filmat dokumentar: trajtimit/ treatment)
3. Certifikatën e regjistrimit si produksion në QKK,
4. Listën e personazheve të ndarë në kategori (Role Kryesore, të dyta, të treta, episodike, figurantë)
5. Emrat e autorëve, koautorëve të parashikuar për realizimin e veprës filmike së bashku me dëshmi mbi nivelin e arsimimit profesional, përvojën profesionale si autorë, koautorë (në vijim - CV),
6. Konstruksionin financiar të projektit (forma e aplikimit merret në QKK).
7. Kontratat që mund të jenë lidhur me bashkëproducentë, donatorë etj.
8. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe nga bashkëproducentët (nëse për një projekt konkurojnë bashkërisht).
9. Materiale tjera shtesë (DVD) me filma të realizuara më parë.

Neni 6

Çdo pjesëmarrës në konkurs ka të drejtë të kërkojë sqarime dhe informacione lidhur me konkursin e shpallur nga QKK.

Neni 7

Projektet filmike të paraqitura pas kalimit të afatit dhe ato që nuk i përmbushin kushtet nga neni 5 i kësaj rregullore nuk do të merren në shqyrtim. Të njëjtat do t'i kthehen paraqitësit në afat prej 3 ditësh pas mbylljes së konkursit.

Neni 8

Afati i konkursit është maksimumi 60 ditë nga dita e shpalljes së konkursit.

Neni 9

Aplikimi me dokumentacionin shtesë nuk u kthehet paraqitësve dhe ruhen si material arkivor i përhershëm, përveç ato nga neni 7 i kësaj rregullore.

Neni 10

QKK, menjëherë pas përfundimit të konkursit emëron anëtarët e Jurisë vlerësuese dhe Komisionit Financiar, përbërjen e tyre do ta publikojë në faqen e saj zyrtare në internet.

KUFIZIMET NË PJESEMARRJE

Neni 11

1. Shtëpitë Filmike që nuk i kanë kryer obligimet ndaj QKK-së për projektet e fituara më parë, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje.
2. Shtëpia Filmike nuk ka të drejtë pjesëmarrjeje me më shumë se dy projekte. Projektet duhet të jenë të kategorive të ndryshme.
3. Producenti dhe Regjisorin nuk kanë të drejtë aplikimi me më shumë se një projekt.
4. Nuk kanë të drejtë pjesëmarrje projektet që kanë konkuruar tri herë.
5. Regjisorin që konkuron me projekt të filmit të metrazhit të gjatë duhet ti ketë së paku të realizuar dy filma të metrazhit të shkurtër ose një film të metrazhit të gjatë.

MIRATIMI I PROJEKTEVE

Neni 12

Qendra Kinematografike e Kosovës zyrtarisht do ti njoftojë pjesëmarrësit në konkurs lidhur me miratimin apo mos miratimin e projektit të tyre.

Njoftimi për miratimin e projektit fitues me të dhënat për paraqitësin e tij dhe kuotën e subvencionimit do të publikohen në shtypin ditor dhe në faqen zyrtare të QKK-së në internet.

Neni 13

Vendimi për miratimin e projektit duke përfshirë edhe kuotën e subvencionimit, nuk është i transferueshëm. Një transaksion i tillë konsiderohet i paligjshëm dhe në rast të këtillë QKK do të anulojë vendimin, përkatësisht kontrata për realizimin e projektit do të konsiderohet e shfuqizuar, me efekt prapaveprues.

Neni 14

Pasi të jetë marrë vendimi për miratim dhe subvencionim të projektit filmik dhe kur shuma e përgjithshme e shpenzimeve të parashikuara për realizim të tij të jetë siguruar 100%, producenti fitues nuk mund të kërkojë a të krijojë burime shtesë pa e njoftuar me shkresë të arsyetuar QKK-në dhe pa marrë pëlqimin e saj me shkrim.

Neni 15

Në rast se shkelen nenet 13 apo 14 i kësaj rregulloreje, atëherë tërhiqet vendimi i QKK-së për subvencionimin e projektit.

MENYRA E SUBVENCIONIMIT

Neni 16

Shuma e subvencionimit realizohet në tri faza të filmat e metrazhit të gjatë dhe në dy faza të filmat e shkurtër, dokumentarë dhe të animuar.

Ecuria e realizimit të projekteve të miratuara

Neni 17

Jo më vonë se 15 ditë nga dita e vendimmarrjes për subvencionimin e projektit, drejtori i QKK-së dhe producenti i projektit fitues lidhin kontratë për subvencionimin e realizimit të projektit.

Me kontratë, përveç tjerash duhet të përcaktohet:

1. Afati për fillimin e xhirimit të veprës filmike (nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj nga dita e lidhjes së kontratës) dhe kohëzgjatja e realizimit të projektit që rezulton me kopjen e parë të filmit (nuk mund të jetë më e gjatë se tetëmbëdhjetë muaj nga nënshkrimi i kontratës);
2. Producenti mund të fillojë me xhirimet atëherë kur e ka kompletuar buxhetin minimum 70% paraprakisht të miratuar nga QKK.
3. Zotimi i producentit për respektimin e standardeve të cilësisë së xhirimit të zërit dhe të pamjeve;
4. Zotimi i producentit që do të përballojë çdo shpenzim deri në shumën e parashikuar dhe çdo tejkalim të shpenzimeve mbi shumën e parashikuar duke mos lejuar zgjatjen e afatit, rënien e cilësisë apo ndonjë shmangje nga skenari, përkatësisht libri i xhirimit;
5. Detyrimi i producentit të informojë QKK për çdo ndryshim në ecurinë e realizimit të projektit;
6. Detyrimi i producentit që të lejojë përfaqësuesve të QKK të ndjekin për së afërmi ecurinë e realizimit të projektit në cilësinë e mbikëqyrësve por pa ndikim në aspektin e shtjellimit artistik;
7. Zotimi i producentit se garanton arsyeshmërinë e kostos si dhe saktësinë, llojshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të kryera, materialeve të livruara e të kontributeve të tjera që shlyhen me pagesa dhe se çdo shlyerje e debive do të bëhet në bazë të dokumenteve përkatëse;
8. Detyrimi i producentit për mbajtjen e evidencave sipas standardeve të kontabilitetit dhe të llogaridhënies si dhe për formimin dhe ruajtjen e dokumenteve përkatëse lidhur me të hyrat dhe të dalurat që kanë të bëjnë me realizimin e projektit;
9. Detyrimi i producentit që të jep informacionet e kërkuara dhe të lejon qasje në dokumentacionin përkatës zyrtarëve të QKK-së, për të mbikëqyr përdorimin e efektshëm e të ligjshëm të mjeteve nga subvencion;
10. Detyrimi i producentit që, me të përfunduar realizimin e veprës filmike, t'i paraqet QKK një raport të plotë së bashku me bilancin përmbyllës (përfshi: Faturat dhe fletëpagesat).
11. Afati përfundimtar për dorëzimin e raportit është 60 ditë kalendarike pas kolaudimit të filmit.
12. Favoret eventuale që do të gëzojë producenti në rast se vepra filmike arrin sukses artistik dhe nëse është realizuar në aspektin financiar me korrektësi dhe efektshmëri;
13. Detyrimi i producentit që të informojë QKK për ecurinë e eksplotimit të veprës filmike dhe për të hyrat e vjelura nga eksplotimi për periudhën që

nga vënia e veprës në eksploatim dhe për tre vjet radhazi.

Neni 18

10% të vlerës së subvencionimit të marrë nga QKK-ja do të ndalet si siguri e ekzekutimit të kontratës nga kësti i fundit (dytë ose tretë, varësisht nga kategoria e projektit)

Shuma e ndalur do të lirohet posi të realizohet kontrata që rezulton me dorëzimin e:

1. Negativit të filmit në QKK (masterit nese punohet ne elektronike),
2. Raportin financiar dhe arsyetimin e duhur financiar për mjetet e subvencionit,
3. Raportin financiar për investimet e bëra nga Producenti (pjesa e investimeve të producentit)
4. Reklamata, posterat, ftesat etj
5. Pas dorëzimit të raportit nga mbikëqyrësi për përfundimin e xhirimeve sipas standardeve të QKK-së, (hartohet nga zyrtari përkatës i QKK-së në afat ligjorë)
6. Raportin përmbyllës të projektit (kostoja e përgjithshme e projektit-hartohet nga zyrtari përkatës i QKK-së në afat ligjorë)
7. Ta ketë marrë certifikatën nga Komisioni i Vizionimit (lejen e shfaqjes së filmit në publik).

SHKEPUTJA E KONTRATES

Neni 19

QKK mund ta shkëpusë kontratën në mënyrë të njëanshme nëse producenti:

1. Ka ofruar të dhëna apo dëshmi të rreme;
2. Nuk i përmbush detyrimet dhe kushtet e kontratës;
3. Ka falimentuar ose është shlyer nga regjistri;
4. Shpërdoron subvencionin;
5. Gjatë xhirit devijon qenësisht nga skenari i paraqitur;
6. Si dhe rastet tjera të parapara me ligj, statut apo me kontratë.

Në rast të zgjidhjes së kontratës, QKK ka të drejtë të kërkojë nga Shtëpia filmike kthimin e plotë të shumës që është subvencionuar prej saj.

ATRIBUTET E QKK-së

Neni 20

Në zbatim të nenit 42.4 dhe 48.2.2 të Ligjit për Kinematografinë, Qendra Kinematografike e Kosovës ka atributin e bashkëproducentit dhe do të marrë pjesë në ndarjen përpjesëtimore të bashkëfitimit nga shfrytëzimi i veprës filmike.

Shpërndarja e fitimeve nga eksploatimi i veprës filmike

Neni 21

Fitimi i realizuar nga shfrytëzimi i veprës filmike shpërndahet në pjesë përpjesëtimore sipas përqindjes së investuar në film për periudhën 3 vjeçare nga fillimi i eksploatimit të veprës.

Fitimi i realizuar nga shfrytëzimi i veprës filmike duhet të shpërndahet një herë në vit, më së largu 15 ditë pas përfundimit të vitit kalendarik.

OBLIGIMET E PRODUCENTIT

Neni 22

Producenti është i obliguar që të depozitojë në Qendrën Kinematografike të Kosovës të gjitha kontratat e eksploatimit që mund të lidhe me distributorë/shfaqës brenda dhe jashtë vendit jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të tyre.

Producenti është i obliguar që Qendrës Kinematografike të Kosovës t'ia dorëzojë raportin vjetor mbi eksploatimin e veprës filmike.

Në rast të mos deklarimit të lidhjes së kontratës nga Shtëpia filmike si dhe në rast fshehje të të ardhurave që rrjedhin nga shitja e veprës filmike do të procedohet sipas nenit 261 e 262 të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TE FUNDIT

Neni 23

QKK aprovon limitet e pagesave (çmimore) që paguan për projekt filmik: artistë, pajisje dhe punëtorë në film.

Limitet e pagesës (çmimorja) shqyrtohet dhe aprovohet nga Këshilli Drejtues së paku një herë në vit, në përputhje me çmimet e tregut në vend dhe rajon.

Çmimorja i bashkëngjitet dhe është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 24

Kjo rregullore hyn në fuqi me rastin e miratimit nga Këshilli Drejtues i QKK-së.

QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS

PRISHTINË: Prill, 2012.

KËSHILLI DREJTUES:


Arben Zharku

Burbuqe Berisha

Agron Vula

Ilir Kabashi

Arben Apolloni



Handwritten signatures in blue ink corresponding to the names listed to the left. The signatures are: Arben Zharku, Burbuqe Berisha, Agron Vula, Ilir Kabashi, and Arben Apolloni.